



01/Nr. 782/2020  
Data: 21.10.2020

## PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e shtatë -VII- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.09.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Sevime Laçi (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), Sear Dernjani (Shef për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtorë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Medin Imishti (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emërgjencë), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Miratimi i buxheti të komunës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2022-2023.
4. Miratimi i planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2021.
5. Miratimi i propozim rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste në territorin e komunës së Hanit të Elezit.
6. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2019.
7. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin 2019.
8. Shqyrtimi i raportit për vlerësimin e performances së Komunës për vitin 2019.
9. Shqyrtimi i informatës mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021.
10. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- përpos këtyre pikave të rendit të punës kemi edhe një material shtesë, kërkesë e z.Sulejman Doshllaku për ndërrim destinim të pronës e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Miratimi i buxheti të komunës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2022-2023.
4. Miratimi i planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2021.
5. Miratimi i propozim rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste në territorin e komunës së Hanit të Elezit.
6. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2019.
7. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin 2019.
8. Shqyrtimi i raportit për vlerësimin e performances së Komunës për vitin 2019.
9. Shqyrtimi i informatës mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021.
10. Miratimi i kërkesës e z.Sulejman Doshllaku për ndërrim destinim të pronës.
11. Të ndryshme.

### U MIRATUA RENDI I PUNËS

## 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Rufki Suma** thekson:- nga data një shtatorë deri më datë tridhjetë shtatorë kemi pasur gjithsejtë nëntë raste pozitive. Nga gjitha këto raste të shëruar janë të gjithë përveç një rast i cili është në spital e që është në gjendje të rëndë intensive dhe diçka tjetër për dallim prej muajve të tjerë nuk kemi pasur.

**Mefail Suma** thekson:- me që vet isha i sëmurë dhe po flasë atë që e kam pa. Në ambulant kam qenë me marr oksigjeno terapinë, boca e oksigjenit nuk më ka furnizuar boll dhe është mirë që të vendosen nëpër secilin krevat. Sa i përket shëbimit nuk kam vërejtje për shkak se është në nivel, mirëpo në dhomën që kam marr infuzion klimë nuk ka pasur dhe ka qenë vapë shumë. Kërkoj që të vendosen klimat sepse temperatura e lartë e shton sëmundjen edhe më shumë.

**Teuta Shkreta** thekson:- sa i përket oksigjeno terapisë pacienti furnizohet sipas përcaktimit të mjekut. Sa i përket përçuesve është një e cila i përqonë tre apo katër pacientë që do të thotë furnizohet një dhomë e plotë me të gjithë ato pacientë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- me që është drejtoresha për shëndetësi prezentë, më mirë do të ishte drejtoresha me dhënë sqarime se sa znj. Teuta si anëtare e kuvendi t të komunës sepse ne e dimë që është në ambulantë. Më mirë do të ishte drejtoresha me një dhënë një informacion të shkurtë për QKMF-në.

**Teuta Shkreta** thekson:- unë vetëm deshta ta paraqesë punën profesionale dhe drejtoreshën nuk e ndalojmë me dhënë informacion.

**Medina Imishti** thekson:- kryetari i komunës për çdo mbledhje e ka dhënë pasqyrën e situatës me pandeminë dhe përveç kësaj në muajin e kaluar e keni pasur një raport shumë më detal dhe në atë raport ishin të specifikuar donacionet, ndihmat dhe të gjitha punët të cilat jemi munduar me i kryer. Është e vërtetë që klimë në atë dhomë nuk ka pasur sepse ka qenë një dhomë për shërbime të tjera por për shkak të situatës jemi mundur me krijuar kushte për me ju shërbyer pacientëve me kovid me mundësit që i kemi pasur.

**Mefail Suma** thekson:- sa i përket bombolave sa janë efektive sepse nuk më kanë furnizuar mjaftë me oksigjen bombola, a ka pasur a nuk ka pasur oksigjen unë nuk e di por më kujtohet se ma kanë ndërruar dhe ma kanë vendosur tjetrën dhe përsëri nuk më kanë furnizuar.

**Sead Vila** thekson:- edhe në seancën e kaluar kam propozuar që për personat që kanë simptome më të theksuara besoj që edhe në shtëpi kanë mundësi me marr një shërbim të tillë.

**Medina Imishti** thekson:- pacientëve që kanë mundësi me ju dhënë shërbime në shtëpi u japin por terapinë e vlerëson mjeku a me ju dhënë në QKMF apo në shtëpi. Në informatën që do ta përcjelli do të jenë të paraqitura të gjitha detajet.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

### **3. Miratimi i buxheti të komunës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2022-2023.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Rufki Suma** thekson:- janë mbajtur dy dëgjime publike për çështjen e buxhetit të komunës dhe prej dëgjimeve publike janë marr të gjitha ato propozime që shumica prej tyre kanë të bëjnë me rregullim të kanalizimeve, rrugica, rrugë dhe me asfaltim të rrugëve. Të gjitha këto propozime i kemi të përcaktuara në kode ekonomike të cilat i kemi të planifikuara në planifikimet buxhetore për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2022-2023. Në kuadër të projekteve të investimeve kapitale janë përfshirë propozimet të cilat janë dhënë nga qytetarët e që nuk kanë qenë në kuadër të listës së projekteve kapitale. Më në detale do ta paraqet drejtori për buxhet dhe financa.

**Shabi Rexhallari** thekson:- bazuar në qarkoret buxhetore që i ka përcjell Ministria e Financave buxheti i përgjithshëm i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021 është në shumë prej 2,520,166 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2022 janë në shumë prej 3,102,888 € dhe për vitin 2023 janë në shumë prej 3,194,754 €. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2021 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje buxhetore: paga dhe shtesa 1,602,781 €, mallra dhe shërbime 335,258 €, shpenzime komunale 67,000 €, subvencione dhe transfere 75,000 € dhe shpenzime kapitale 440,127 €. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Sabedin Hasallari** thekson:- në parim e përkrahë këtë projekt buxhet por me disa vërejtje të vogla dhe disa propozime që do ti parashtrorë. Si krijohet buxheti i komunës. Te arkëtimi i borxheve që i ka komuna është shënuar supozimi se komuna do të vazhdojë me arketimin e tyre por fjala supozim duhet të hiqet sepse krijohet përshtypja se ato borxhe nuk ekzistojnë. Propozim numër një e kam sigurimin e ujit të pishëm për qytetarët e Hanit të Elezit. Komuna për vitin 2021 dhe 2022 ka paraparë mjete financiare por prioritet duhet ti ipet ujit të pijes sepse atë që e keni potencuar në tabelë është e barabartë me shtrimin e kupëzave të betonit . Duhet ta keni parasysh dhe ti ipet rëndësi shumë më e madhe çështjes së ujit të pijes. Propozoj që rruga Pustenik deri te lapidari “Xhemsedin Suma” dhe “Nuri Bushi” të shtrohet me zhavor. Kërkoj që të shtrohet me zhavor rruga e Lagjes Hasallari e cila lidhet me rrugën e Lagjes Hunel për vitin 2021. Kërkoj që rruga e Lagjes Hasallari të ndërlihet me rrugën Gorancë - Krivenik sepse nuk ka ndonjë kosto të lartë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- po më vjen shumë mirë se për herë të parë dëgjova një anëtarë të kuvendit të komunës nga pozita i cili diskutojë për çështjen e projekt buxhetit. Pajtohem me kërkesat që i parashtrorë parafolësi dhe kisha dashur edhe nga të tjerët që në këtë projekt buxhet të kërkojnë me bërë ndryshime sepse ne si parti demokratike i kemi vërejt se disa pika nuk shkojnë drejtë zhvillimit ekonomik të komunës për arsye se më shumë janë përsëritur projektet sepse është ndarë buxheti më shumë nga interesat politike të komunës e nuk i plotëson kërkesat e qytetarëve . U potencia që shumica e propozimeve që i kanë dhënë qytetarët gjatë dëgjimeve publike janë përfshirë në projekt buxhet, si teori po them që është në rregull sepse nuk mund të pranohen të gjitha projektet që propozohen nga ata që marrin pjesë në dëgjimet publike, e që unë po konsideroj që edhe këtu në kuvend jemi qytetarë që kërkojmë për hyrje të projekteve në planifikimet buxhetore për vitin që vjen. Cilat janë ata projekte që ju i keni marr nga qytetarët të cilat ishin propozime të qytetarëve dhe ju i keni planifikuar në projekt buxhetin e juaj që e keni paraparë nga lista e prioriteteve që i ka pasur kryetari në fillim të vitit dhe a përputhen ata kërkesa. Nuk ka diçka koncize që potencohet se ky numër i projekteve nga

dëgjimet publike që i keni pasur me qytetarë që të hyjnë në projekt buxhet. Shpërndarja në kategoritë buxhetore nuk shihet që mund të dërgon nga zhvillimi ekonomik sepse po që se i bëhet një analizë shumë e shkurtër ata që merren me këtë fushë shihet që ka një lloj divergjence dhe mos përputhje të interesave të qytetarëve. Te zyra e kryetarit të komunës janë të planifikuara në tërësi 139 000 € për vitin 2021, ndërsa te zhvillimi ekonomik janë të planifikuara 23 000 € dhe nuk mund të bindet dikush se mund të ketë zhvillim ekonomik kur zyra e kryetarit ka shtatë apo tetëfish më shumë buxhet se sa zyra për zhvillim ekonomik dhe kjo vazhdon për tri vitet e ardhshme. Te drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale nuk ka ndonjë ndryshim të madh është gati se e njëjta. Në KPF kam diskutuar për kontratën kolektive dhe nuk parashihet te arsimi çështja e shujtave, e fatmirësisht këtu në kuvend jemi tre apo katër anëtarë që jemi në arsim dhe e dimë mirë këtë çështje. Nuk është mirë me personalizuar por është kërkesë e gjithë personelit arsimorë në komunën e Hanit të Elezit që marrëveshja të implementohet duke u bazuar në zotimin e kryetarit të komunës i cili ka potencuar që nëse vetëm një komunë e implementonë këtë marrëveshje unë do të jem i dyti që do ta implementojë. Ka komuna të cilat e kanë implementuar dhe ka komuna të cilat janë në proces, ndërsa këtu nuk parashihet. Te tabela dy të shpenzimet kapitale u potencuar që të bëhen shtrimi i rrugës me zhavorr dhe unë mendoj që duhet të bëhet zgjidhje afatgjate sepse gjithmonë kur bien shi duhet të shtrohet me zhavor. Unë kam kërkuar disa herë që të rregullohet trafoka te varrezat e dëshmorëve e cila është urgjente por në planifikimet buxhetore nuk është përfshi dhe kërkoj në mënyrë decizive që të hynë në planifikimet buxhetore për vitin 2021 sepse është interes i qytetarëve në përgjithësi trafoka. Të hynë në planifikimet buxhetore kanalizimi dhe shtrimi i rrugës me asfalt të lagjes Ballazhi në fshatin Pusteni, për shkak se është parashtruar kërkesë që dy vite. Unë mendoj që projekt buxheti duhet të rishkohet me këto kërkesa që u potencuan dhe pastaj të procedohet për miratim, për ndryshe partia demokratike nuk do ta voton këtë projekt buxhet.

**Akif Shkreta** thekson:- u potencua që nuk po fletë pozita dhe është jo demokratike sipas meje të ja cenosh dikujt të drejtë a të fletë apo të mos flet por është çështje personale e individit se kur flet. Buxheti i vitit të kaluar ka pasur më shumë vërejtje por ky buxhet ka më pak vërejtje në disa pika, andaj partia demokratike është dashur me diskutuar atëherë kur ka pasur gabime e jo sot, e ndoshta nuk ka marr pjesë në dëgjime publike dhe ndoshta nuk e kanë lexuar materialin, ndërsa mbase e shpreh tek ne pse nuk flasim.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- koleg i nderuar i dyfishtë nuk ja cenova të drejtën askujt, por unë potencova që po më vjen mirë që e dëgjova dikend nga pozita që po diskuton për çështje të projekteve për me hyjë në planifikimet buxhetore dhe unë nuk ja cenova askujt të drejtë. z.Akif unë i kam lexuar materiale por edhe në mes të kolegëve e kam diskutuar që mos të bëhem i tepër duke kërkuar diçka dhe me u menduar që pasna ndonjë interes shumë personal. Unë parashtrova çështjen e kontratës kolektive dhe me që ju nuk po diskutoni kërkesat i dini ju që jeni në arsim sepse për çdo ditë jeni aty. Kërkesat janë të ligjshme sepse sindikata ka paralajmëruar se do të shkon përmes institucioneve të drejtësisë që mund të ndikoj në shpenzime të avokatit dhe mund të ndikojë në performacë të komunës sepse ne nuk po duam që komuna me pasur performacë të keqe. Kërkesën e projekteve që e parashtrova është vullneti i juaj dhe unë nuk mundem me ja imponuar askujt dhe as të drejtë me ja cenuar dikujt që me kërkuar projekt tjetër por ju inkurajova edhe juve që të propozoni projekte si qytetarë dhe ata që ju i përfaqësoni sepse unë nuk përmenda parti apo dikend individualisht.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- kërkoj sqarim te tabela numër pesë te investimet kapitale te ndërtimi i mbikalimeve në zonat urbane në cilat vende janë paraparë. Në mbledhje të komitetit për komunitete kemi pranuar një kërkesë nga kryetari i këshillit të lagjes Meliq për çështjen e rrugës te varrezat e Hanit të Elezit në vendin e quajtur rrafshë e cila është dëmtuar dhe është mbyllur për shkak të rrethojës që është bërë tek varrezat. Nga kryetari i kësaj lagje është parashtruar kërkesë që të rregullohet kjo rrugë dhe të hynë në planifikimet buxhetore për vitin 2021.

**Sabrije Krasniqi** thekson:- a ka filluar me u bërë ndriçimi i rrugës te pjesa që është nën hekurudhë. Kërkoj që të bëhet trotuari nga Lagja Ramuk deri te shkolla fillore “Kështjella e Diturisë” sepse nxënësit udhëtojnë çdo ditë për në shkollë dhe po vozisin me shpejtësi të madhe dhe është rrezik për nxënësit. Është mirë të bëhet një park me lodra për fëmijë në fshatin Paldenicë.

**Mefail Suma** thekson:- afër 60 % e buxhetit shpenzohet për paga dhe për shërbime komunale, ndërsa për shpenzime kapitale parashihen 17 % e buxhetit që është një shumë e vogël. Nga propozimet që janë propozuar në dëgjim buxhetorë vetëm për fshatin Gorancë ishte propozuar për çështje të ujit, ndërsa për Han të Elezit asnjë propozim nuk ishte dhënë. Në tabelë shihet që janë ndarë 40 000 € për shtim të kapaciteteve të ujit, çfarë kapacitete të ujit do të shtohen me këtë shumë sepse Hani i Elezit ka nevojë për ujë shumë më shumë se këto mjete të cilat janë planifikuar. Më herët është diskutuar se Hanin e Elezit me ujë e furnizon kompania "Bifurkacioni" por duhet ta dimë që kjo kompani e ka për obligim vetëm me menaxhuar ujin e nuk e ka për me furnizuar. Për me shtuar kapacitetin e ujit dhe sasinë e ujit është detyrë e komunës. Komuna duhet të mundohet për me i rrit asetet për shtim të kapacitetit të ujit për shkak se me këtë shumë nuk mund të bëhet. Në këto planifikime që janë bërë deri në vitin 2023 nuk shihet që keni bërë ndonjë projekt për shtimin e kapaciteteve të ujit.

**Florim Shkreta** thekson:- e përkrah propozimin e znj. Hanumshahe Dibrani për kërkesën e kryetarit të këshillit të lagjes Meliq për rregullimin e rrugës tek varrezat e qytetit në vendin e quajtur Rrafshe dhe kërkoj që kjo rrugë të hynë në planifikimet buxhetore për vitin 2021. Kërkoj në planifikimet buxhetore për vitin 2021 të hynë edhe rregullimi i trafosë të varrezat e dëshmorëve në fshatin Pusteni. Ku është paraparë ndërtimi i stacionit të autobusëve. Shtrimi me kupëza betoni nëpër zona urbane dhe rurale është paraqitur por a lejohen me u shtruar edhe pjesët që janë private. Në cilat vende në Han të Elezit janë paraparë rregullimi i mbikalimeve. Ndërtimi i shtëpive dhe banesave për banim social ku janë planifikuar me u ndërtuar.

**Sead Vila** thekson:- kur të bëhen planifikimet buxhetore është mirë që të jenë në harmoni me kërkesat e qytetarëve. Buxheti që është planifikuar për vitin 2021 dhe planifikimet për vitin 2020 dhe 2023 duhet të mendohen pikat që janë më kritike për shkak se janë më vitale për jetën tonë të përditshme. Umë mendoj që duhet të planifikohen disa pika që janë më të nevojshme sikur çështja e shtimit të kapaciteteve të ujit, çështja e mbrojtjes së mjedisit, subvencionimi për hapjen e bizneseve për shkak se janë pika që do ta bënin jetën më pozitive. Nëse kalohet në mësim onllajn është mirë me planifikuar buxhet për ata fëmijë që nuk kanë mundësi me u kyç në mësim onllajn me i kompletuar me pajisjet të cilat ju duhen. Është mirë të planifikohen mjete për shkak se mund të ketë konteste gjyqësore për çështjen që është planifikuar me kontratën kolektive sepse kemi shumë avokatë që vijën dhe interesohen për këtë çështje. Nëse është e drejtë ligjore që i takon asaj kategorie ashtu siç i marrin sektorët e tjerë ato benificione është mirë të planifikohen edhe për këtë sektor.

**Sabedin Hasallari** thekson:- te tabela numër tre granti për shëndetësi për vitin 2022 kemi një ngritje qind për qind për të cilën kërkoj një sqarim. Për ndërtimin e bazenit për ujë në fshatin Gorancë janë planifikuar 25 000€ ndërsa në total janë 20000 €. A do të shtrohet rruga Gorancë – Krivenik me asfalt.

**Rufki Suma** thekson:- shumica e projekteve janë të planifikuara në kuadër të projekteve të përgjithshme. Shumica e propozimeve të qytetarëve kanë të bëjnë me shtrim të rrugëve me kupëza betoni në lagje të ndryshme, asfaltim të rrugëve. Komuna e ka kodin e projekteve shtrimi i rrugëve me kupëza betoni në zonat rurale dhe urbane të komunës së Hanit të Elezit dhe për çdo vit në secilin fshat e kemi rregulluar nga një rrugë. Asfaltimi i rrugës Krivenik-Gorancë me mjetet financiare të komunës nuk mund të bëhet dhe nuk është shumë prioritet në raport me projektet e tjera por kërkesën do ta adresojmë në Ministri të Infrastrukturës dhe nëse miratohet mund të realizohet për vitin 2021. Çështja e rrymës në fshatin Pusteni është obligim i KEDS-it edhe nëse donë komuna nuk mundet me i kryer. Sa i përket rrugës në fshatin Pusteni duhet të bëhet publike dhe pastaj komuna investon. Çështja e kanalizimit është problem me pronat dhe nëse zgjidhet çështja e pronave komuna do të investon. Sa i përket rrugëve që u potencuan me i shtruar me zhavor, komuna e ka kodin për këtë çështje dhe për rrugën për të pllakat përkujtimore kemi kërkuar nga ministria që të shtrohet me asfalt. Sa i përket rrugës të Lagjës Hasallari është hapur dhe është shtruar rruga por ta shohim sa është e qëndrueshme. Po që se do të kemi mjete financiare do të i lidhim të gjitha rrugët që janë për nevojat e qytetarëve por komuna i rregullon ato projekte që janë më me prioritet për qytetarin. Mbikalimet janë të planifikuara për vitin 2022 por me prioritet ka qenë mbikalimi të hekurudha por për shkak të punimeve që do të i bëjnë hekurudha nuk mund të kryhen. Jemi të interesuar që me bërë mbikalim me ashensorë në qendër të komunës së Hanit të Elezit dhe të hekurudha dhe brenda mundësive që do të kemi planifikojmë në vitin 2022

me i rregulluar. Sa i përket rrugës te varrezat në Rrafshë tjetër çështje është aspekti politik tjetër çështje është aspekti real sepse është rruga nga Ura e Fejzës, që shkon te Lagja Meliq, Gorancë dhe në disa fshatra tjerë, mirëpo ata kërkojnë që me prishur rrethojën. Krahës rrethojës në fund të varrezave e kemi përcaktuar një vend që me mundur me riparuar me shkallë që të paktën nxënësit me ecë për në shkollë. Sa i përket trotuareve dhe parqeve në fshatin Paldenicë do të shikohen mundësitë buxhetore sepse buxheti është më i vogël për vitin e ardhshëm. Gjelbërim dhe parqe kemi rregulluar në fshatin Gorancë por i kanë dëmtuar dhe përsëri kërkojnë. Çështjen e ujit e kam diskutuar me të gjithë sepse kemi pasur probleme me Zyrën Zvicerane dhe kompaninë “Bifurkacioni” dhe përsëri kam takim me CDI-në dhe kompaninë “Bifurkacioni” sepse zyra Zvicerane i lëshon mjetet financiare. Fillimisht mbi dhjetë për qind të buxhetit e kemi planifikuar dhe e kemi hequr se nëse mbeten në atë kod nuk mund të realizojmë dhe mbeten suficit, ndërsa Zyra Zvicerane vazhdimisht premtan për këtë çështje. Zyra Zvicerane ka premtuar që do ta bënë riparimin e fabrikës pastaj rrjetin e ujësjellësit dhe për pjesët të cilat nuk i kanë paraparë komuna do të investon. Çështja e banimit social është paraparë për vitin 2022 të pronat e ish armatës jugosllave dhe po në këtë vend ka qenë i paraparë edhe stacioni i autobusëve me u rregulluar. Për Lagje të Re ka pasur kërkesa në debat për rregullimin e sallës sportive por është problem çështja e pronësisë. Për çdo vit komuna ka participuar njëzet deri në njëzet e pesë për qind me organizata të ndryshme për me hapur biznese. Komunës së Kaçanikut ja ka bllokuar xhirollogarinë për kontratat të cilat nuk ka qenë obligative por Ministria ka nënshkruar marrëveshje e nuk ka nënshkruar komuna e Kaçanikut por ne jemi të interesua se si do të veprojnë komunat tjera atëherë do të veprojmë edhe ne si komunë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- mënyra se si e paraqet ty në teori është e pamundshme por realisht mënyrë është cinike sepse potencove që kemi pranuar kërkesa të qytetarëve për projekte që të hyjnë në planifikimet për vitin 2021, ndërsa në anën tjetër potencon që me një far forme se çka të vijnë ajo rrugë prej andej e atje por un them që është kërkesë e tyre. Ju potenconi që në planifikimet buxhetore i kemi paraparë projektet që janë në interes të qytetarëve. Unë mendoj që nuk është mirë me injoruar propozimet e qytetarëve sepse kemi projekte më të nevojshme të cilat janë më me rëndësi e jo të potencohet me injorancë. Për projektet që potencove që me i bërë pronë publike dhe nuk do të ketë problem por shumë rrugica janë bërë pronë publike që as banorët nuk kanë marr pjesë në procedura për me i bërë prona publike por vetë komuna i ka kryer këto procedura. Projektin që po e kërkojë unë vet komuna mundet me kryer por vetëm nëse nuk e ka vullnetin. Është mirë që me ju ndihmuar qytetarëve sepse po paguajnë taksa. Sa i përket trafos është mirë të bëhet për interes të qytetarëve sepse nuk duhet të potencohet që për inatin të KEDS-it nuk e bëjë por duhet të bëhet për hir të qytetarëve.

**Shabi Rexhallari** thekson:- te tabela katër pik dy për ndërtimin e rezervarit të ujit të pijes në fshatin Gorancë shuma është rregulluar. Sa i përket buxhetimit buxheti i komunës përbëhet nga transferet qeveritare dhe nga të hyrat vetanake. Në kuadër të transfereve qeveritare është grandit i përgjithshëm, fondi i arsimit dhe i shëndetësisë që përcaktohet nga Qeveria. Sa i përket shëndetësisë komisioni i grandeve ka vendosur në atë formë.

**Refet Kalisi** thekson:- sa i përket ndriçimit publik ka pjesa e hekurudhës nuk është bërë për shkak të punimeve që do të bëhen në rregullimin e hekurudhës ndërsa në mbikalim është bërë ndriçimi.

**Kryesuesi** thekson:- kryetari potencojë që shumica e propozimeve që janë dhënë nga dëgjimet buxhetore janë të përfshira në projekt buxhet dhe nëse nuk keni edhe ndonjë diskutim e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 11 për, 3 kundër nga (grupi parlamentarë i PDK-së), 1 kundër nga (grupi parlamentarë NISMA).

**U MIRATUA BUXHETI I KOMUNËS SË SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2021 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITIN 2022-2023**

### 3. Miratimi i planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2021.

**Kryesuesi** thekson:- për hartimin e planit të punës së kuvendit është themeluar komisioni i cili e ka harmonizuar planin e punës së bashku me ekzekutivin e komunës. Për vitin 2021 janë planifikuar që të mbahen dymbëdhjetë mbledhje. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Mefail Suma** thekson:- ndoshta ligjërisht dhe logjikisht është e pa pranueshme propozimin që do ta parashtrorë, mirëpo për pranimin e ndonjë punëtori në punë po dihet se kush do të punësohet pa u shpallur konkursi. Do të ishte mirë që në planin e punës të hynë informatë rreth punësimit sepse duam ta dimë se a është pranuar në mënyrë ligjore sepse ne kemi kontakte me qytetarët.

**Kryesuesi** thekson:- këshilltari ka të drejtë me parashtruar pyetje çdo herë dhe nuk është e nevojshme me hy në plan të punës sepse ke drejtë me kërkuar informacion për ndonjë çështje.

**Sabedin Hasallari** thekson:- në plan është paraparë propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë propozoj që të shtohet edhe për nxënës.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- buxheti u miratua dhe është dashur që në planifikimet buxhetore me hyjë për vitin 2021.

**Rufki Suma** thekson:- komuna e ka të miratuar rregulloren për ndarjen e bursave që e përcakton se kush mund të jetë përfutues i bursës dhe po që kemi mjete financiare duhet të ndryshojmë rregulloren.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2021

### 5.Miratimi i propozim rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste në territorin e komunës së Hanit të Elezit.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sevime Laçi** thekson:- rregullorja është shqyrtuar në komitet për politik e financa dhe kuvend të Komunës. Është mbajtur diskutimi publik për këtë rregullore dhe pjesëmarrës ishin disa pronarë të bizneseve të cilët kanë dhënë propozimet e tyre. z.Veton Zeqiri ka propozuar që sa i përket kujdestarive 24 është shumë e vështirë për barnatorët për shkak se rastet pas orës 24 trajtohen në urgjencë dhe nuk kanë nevojë për barnatore. Propozoj që mos të jetë në këtë formë dhe dita e diell është mirë të jetë pushim. znj.Besiane Bushi ka propozuar që dita e diell dhe ditët e festave që janë për sektorin publik të jetë festë zyrtare edhe për sektorin privat. Do të ishte mirë që drejtoria për shëndetësi ta përcakton orarin dhe Barnatorja e cila është hapur pas orës 24 ta ketë dritën dhezuar dhe plusin në mënyrë që të funksionon si barnatore e hapur ta ketë numrin e telefonit. Barnatorja e cila e ka atë ditë kujdestari duhet të ketë parasysh që barnatorët tjera mos me qenë të hapura. z.Afrim Shkreta ka propozuar që dita e diell të jetë pushim. z. Nexhemdin Kuka propozon që për gastronomi dita e diel të jetë pushim. Krahas propozimeve që janë bërë në debat publik kemi edhe propozime elektronike të cilat janë dhënë, z.Mexhait Kalisip propozon që ditën e diell gurthyesit mos të punon prodhimi por transporti të lejohet. Propozon që orari për sezonës verore të jetë nga ora 07:00 deri 20:00, ndërsa për periudhën dimërore prej orë 07:00 deri në ora 18:00. Propozimi i Kompanisë “Sharrcem” është se ne si Sharrcem Sh.P.K. (Fabrikë për Prodhimin e Çimentos), propozojmë që të ndryshohen/plotësohen neni 15 dhe 25 të Propozim-Rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës të Subjekteve Afariste në territorin e Komunës së Hanit të Elezit si vijon: neni 15 Orari i Punës në miniera dhe gurore (industria nxjerrëse) prej ora 07:00-19:00 periudha verore ndërsa nga ora 07:00-17:00 periudha dimërore. Ndërsa, sa i përket punës në Objektin e Thërmueses për dy periudhat (verore e dimërore) orari është : 07:00-15:00 ndërrimi i parë dhe 15:00-23:00 ndërrimi i dytë.

ndryshim/plotësimin e nenit 25 – Ruajtja e Rendit dhe Qetësisë Publike, bashkangjitur me këtë e-mail ju dërgojmë: Komentet duke i shprehur në mënyrë tabelare Vlerat e Lejuara të Emisioneve të Zhurmës, bazuar në Ligje, Udhëzime Administrative, Leje të Integruara dhe Direktiva të BE-së. Përveç këtyre propozimeve kemi edhe propozimin e drejtorisë së shëndetësisë që ka pasur takim me përfaqësuesit e barnatoreve.

**Florim Shkreta** thekson:- janë shumë disa pika që bien në kundërshtim me këtë rregullore. Neni 5 pika dy, të gjitha subjektet afariste janë të obliguara që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre ekonomike të mos ndikojnë negativisht në prishjen e qetësisë së banorëve për rreth. A është menduar këtu për kompaninë “Sharrcem” e cila vazhdimisht bënë zhurmë. Neni shtatë pika dy gjellëtoret dhe qebaptoret punojnë çdo ditë pune është përcaktuar periudha verore dhe periudha dimërore, por është mirë të mendohet për pjesën e veprimtarive të kufiri se mbijetojnë për shkak se punojnë pas mesnatës sepse ka fluks të udhëtarëve. Duhet për këto veprimtari të ketë orar më të përshtatshëm. Neni pesëmbëdhjetë pika 1.3 është potencuar që gurthyesit ditën e diel nuk punojnë, është mirë të kemi një sqarim shtesë. Neni 17 ndërmarrjet ndërtimore është potencuar që ditën e diel nuk punojnë por shumë kompani private merren me suvatim dhe me ndërtim dhe është mirë që ta shfrytëzojnë edhe ditën e diel për me punuar. Neni 18 Orari i punës të veprimtaritë: furnizim me ujë, kanalizim, veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave; rikuperimi i materialeve, trajtimi i mbeturinave është përcaktuar që të punojnë 24 orë por bartja e mbeturinave nuk është mirë të bëhet ditën e diel. Neni 21 pika 3 Motelet, Hotelet dhe Restorantet rreth magjistrales mund të punojnë pandërprerë (24:00) orë, ndërsa neni 23 pika 2 Restorantet, kafiteritë, shitoret ushqimore që janë nën menaxhimin e pikave të shitjes së karburanteve, mund të punojnë deri në ora 24:00 h dhe mund të zgjasin orarin e punës deri në ora 02:00 h, sipas nenit 26 të kësaj rregullore, mirëpo unë mendoj që kjo bien ndeshë me nenin 21. Neni 26 subjektet të cilët kërkojnë leje për vazhdimin e orarit të punës jashtë afatit të caktuar me këtë rregullore, duhet t’i drejtohen me kërkesë organit kompetent, përkatësisht Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik minimum tri ditë para ushtrimit të asaj veprimtarie. Ata të cilët kërkojnë leje për me vazhduar veprimtarinë e tij jashtë këtij orari a paguajnë taksa shtesë dhe a mundeni si drejtoreshë me i dhënë leje bizneseve për vazhdimin e orarit të punës pavarësisht se ndoshta është pengesë për qytetarët edhe ditëve të vikendit. Neni 27 parasheh orarin e tregjeve por a keni menduar ndonjë vend më të përshtatshëm për shitësit të cilët produktet e tyre i shesin në rrugë. Neni 28 subjektet afariste janë të obliguara që me rastin e festave zyrtare të vendosin flamujt shtetëror është mirë të përcaktohet e cilin flamur.

**Teuta Shkreta** thekson:- kërkesë kam nga subjektet afariste që të zgjatet orari i punës të pjesa të kufiri për shkak se punë kanë më shumë natën. Sa i përket orarit të punës për barnatoret është mirë të mbetet sikur që është paraparë në nenin 11 dhe e mbështesë këtë orar që pas orës 22:00 barnatoret të punojnë me rrotacion.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- rregullorja ka kaluar në procedura dhe janë edhe kërkesat e debatit publik por drejtorja e shëndetësisë e ka sjellë edhe një propozim. Cila është arsyeja që duhet të ndryshohet orari në mënyrë që të ju kufizohet puna sepse ndoshta atë duan me punuar dhe unë mendoj që duhet të punojnë katër barnatoret që janë. Unë mendoj që ky propozim është i tepër dhe ne të punojnë për shkak se nuk ja prishin qetësinë askujt. Qebaptoret të kufiri është mirë të punojnë sepse nuk ja prishin qetësinë askujt.

**Isni Bushi** thekson:- nëse është nevoja orari i punës të zgjatet për lokalet të cilat punojnë të kufiri por është dashur që në debat publik me marr pjesë dhe me i parashtruar kërkesat e tyre. Sa i përket barnatoreve drejtorja e shëndetësisë është mirë tu a cakton një orar sepse ndoshta ata nuk duan me punuar 24:00 por duan me pushu ditën e diell. Unë e përkrahi propozimin e drejtorisë që është dhënë.

**Sead Vila** thekson:- është mirë të specifikohen oraret sepse janë veprimtari që mbajnë familjen. Pjesa magjistrale që është ka kufiri, apo pjesa e rrugës që janë pompat e benzinës dhe restorantet është mirë të shtohet një pjesë që janë ndishme dhe t’i kemi si prioritet. Nëse vendoset orari është mirë mos me pasur një lloj laramanie por duhet të respektohet për të gjithë njëjtë, ndërsa rastet që bëhen me kërkesë sipas nenit 26 mendoj që janë specifike.

**Sevime Laçi** thekson:- rregullorja është hartuar prej komisionit i cili është në përbërje prej shtatë anëtarëve. Sa i përket qebaptoreve që u potencua mund ta plotësojmë te neni 21 që me bërë pa ndërprerë dhe veprimtaritë tjera. Propozimin për të gurëthyesit është dhënë nga përfaqësuesi i bizneseve por kemi pasur edhe ankesa nga banorët dhe kemi propozuar në këtë mënyrë . Neni 17 ndërlidhet me pikën e dytë dhe mund të marrin leje dhe drejtorja e analizon. Sa i përket barnatoreve përgjigje jep drejtoresha sepse ne si komision e kemi dhënë propozimin tonë.

**Rufki Suma** thekson:- deri më tani nuk kemi pasur rregullore por kemi funksionuar me vendim por kemi planifikuar ta bëjë një rregullore të tillë dhe nëse ka vërejtje në të ardhmen mund të bëhen plotësime ndryshimet. Pjesëmarrja e bizneseve në debat publik ka qenë e mirë dhe kanë kërkuar që dita e diell të jetë pushim. Diskutime ka pasur për orarin e barnatoreve, për gurëthyesit dhe lokalet te kufiri dhe është mirë që edhe veprimtaritë biznesore që janë te kufiri të punojnë 24 orë. Për orarin e barnatoreve drejtoresha e shëndetësisë e ka harmonizuar orarin dhe i ka specifikuar në nenin 11 të cilen e keni para vetës. Po ashtu kemi kërkuar që dita e del të jetë pushim për gurëthyesit por nëse ka kërkesë nga kompania “Sharrcem” që kërkohet transport , gurëthyesve tu mundësohet vetëm transporti e jo prodhimi. Kompania “Sharrcem” ka kërkuar që të respektohet Udhëzimi Administrativë sa i përket zhurmës. Me këtë propozime që kërkohen të harmonizohen kërkojmë që të miratohet rregullorja.

**Florim Shkreta** thekson:- për të mirën e pronarit kërkojë që në rregullore të jetë që edhe transporti mos me u bërë sepse nëse lejohet i sjell probleme edhe pronarit të kompanisë për shkak se ankesat e banorëve janë të vazhdueshme dhe drejtoresha ndoshta nuk ka informim për shkak se qytetarët kërkojnë me pushuar nëpër shtëpitë e tyre. Nëse potenconi që ditën e diell me ndërpre prodhimin e me lejuar transporti do të thotë që je duke ja lejuar për shkak se zhurma është e njëjtë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- janë katër barnatore , nuk krijojnë zhurmë dhe nuk kanë ndonjë konflikt interesi me njëra tjetrën dhe nuk është mirë me u krijuar kjo tollovi. Katër persona është mirë me i ftuar në takim dhe me vendosë pa asnjë lloj divergjence. Duhet edhe për veprimtaritë biznesore të ju lejohet 24 orë të kufiri me punuar. Nëse për shkak të specifikave që ka kompania “Sharrcem “ është mirë ta analizojmë dhe të ju lejohet transporti ditëve të diele gurëthyesve sepse nëse e ndalojmë kompania “Sharrcem” detyrohet me marr diku tjetër.

**Medina Imishti** thekson:- orari do të jetë i njëjtë nga ora tetë deri në ora njëzet e dy po pas orës njëzet e dy me qenë në gadishmëri një barnatore deri në orën tetë të mëngjesit të ditës tjetër.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- unë fokusin e diskutimit e kam që ditën e diell dhe ditëve të festave duhet të punojnë dhe për çfarë arsye keni propozuar që mos me punuar.

**Akif Shkreta** thekson:- na është dhënë propozimi nga drejtorja e shëndetësisë që është koordinuar me drejtorinë për zhvillim ekonomik dhe me pronarët e barnatoreve. Kjo po bëhet jo për interesave të pronarëve të barnatoreve por për interesa të qytetarëve dhe duhet ta mbështesim. A ka elemente diskriminuese nëse marrim vendim me ja përcaktuar orarin e punës dhe a keni informacion se si veprojnë komunat e tjera. Sipas informacioneve që kam në komunën e Ferizajt një barnatore është kujdestare 24 orë.

**Florim Shkreta** thekson:- ju doni me lejuar transportin për te gurëthyesit ndërsa lodheni tu diskutuar për barnaret të cilat të gjitha me nejtë hapur është në rregull por unë mendoj që pronarit mund të i sillni probleme për shkak se banorët janë tu ankuar . Në dëgjim publik as një për qind e banorëve të fshatit Seçishtë nuk kanë marr pjesë , mirëpo e lusë parafolësin tim që të diskuton për këtë rast sepse vetë personalisht ankohet që janë tu më penguar. Më mirë do të ishte edhe për pronarin që ti ndalohet edhe transporti ditën e diel vetëm për ndonjë rast urgent.

**Akif Shkreta** thekson:- unë as nuk i ndaloj gurthyesit por as nuk i lejojë por është çështje procedurale dhe ligjore që ka marr leje shumë më herët dhe vazhdon punën. Banorët një pjesë ankohen dhe një pjesë nuk ankohen e disa flasin nëpër kafe, e disa ndryshojnë në moment të caktuar.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë rregullore, nëse nuk ka e hedhë në votim duke i marrë për bazë vërejtjet e kryetarit të komunës të cilat u dhanë dhe propozimin e drejtorisë së shëndetësisë të neni njëmbëdhjetë, rezultati i votimit ishte 11 për, 1 kundër, 2 abstenim nga (grupi parlamentarë i PDK-së).

#### **U MIRATUA PROPOZIM RREGULLORJA PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS TË SUBJEKTEVE AFARISTE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT**

### **6. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2019.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- opinionin e auditimit është opinion i pamodifikuar. Në këtë raport kemi shtatë rekomandime në kuadër të këtij raporti. Më gjerësisht e keni në material dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

### **7. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin 2019.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- në bazë të ligjit pas pranimit të raportit të auditimit kemi afat prej tridhjetë ditëve për me hartuar planin për zbatimin e rekomandimeve të auditorit. Në material i keni planifikimet se kur planifikohen të realizohen këto rekomandime.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

### **8. Shqyrtimi i raportit për vlerësimin e performances së Komunës për vitin 2019.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Rufki Suma** thekson:- sa i përket performancës komuna e Hanit të Elezit është në vendin e dytë, mirëpo kemi pasur disa vërejtje në indikatorët të cilët janë bërë dhe pyetjet të cilat janë bërë në kuadër të asaj dhe kemi pasur pakënaqësi. Ne kemi dhënë vërejtje sepse na kanë radhitur në vendin e gjashtë apo shtatë dhe në momentin që janë marr për bazë vërejtjet që i kemi dhënë kemi kaluar në vendin e dytë. Në bazë të kësaj performance 17 komuna e kanë fituar të drejtën për me u shpërblyer me grand. Ne jemi radhitur në vendin e dytë dhe kemi 70 000 €, ndërsa komuna e Prishtinës mund të jetë në vendin e shtatëmbëdhjetë por sipas numrit të banorëve i merr 800 000 €. Nuk mund ti themi garë por mund të themi që është stimulim i komunave sipas numrit të banorëve. Realisht komunës së Hanit të Elezit duhet të i takojnë 226 000 €. Në takimin e kryetarëve të komunave kemi reaguar se është një padrejtësi pikërisht për shkak të reagimit tonë se Ministria e Pushtetit Lokal dhe Demosi nuk duan me bërë transparencë e kanë bërë shpëputjen dhe Ministria e Pushtetit Lokal e ka ndërprerë këtë grand por komunat janë ankuar dhe janë në bisedime me kryeministrin.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 9. Shqyrtimi i informatës mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sear Dernjani** thekson:- viti shkollorë ka filluar sipas udhëzimit të MASHT-it dhe sipas udhëzimit administrativ Kovid-19. Janë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollorë është bërë dezinfektimi i të gjitha shkollave, është formuar komisioni i taskë forcës në arsim , është bërë shenjëzimi për mbajtjen e distancës, të gjitha shkollat janë pajisur me dezinfektuesë dhe pajisje higjienike dhe të gjithë nxënësit janë pajisur me maska mbrojtëse. Nxënësit janë pajisur me libra shkollorë duke filluar nga parafillorët e deri në klasën e nëntë të cilat janë siguruar falas nga MASHT-i. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Samire Curri** thekson:- a ka paraparë komuna staf rezervë në rast se nëse sëmuret ndonjëri prej mësimdhënësve? Sa është numri i testeve të mësimdhënësve nëpër shkolla?

**Sabrije Krasniçi** thekson:- disa nxënës dëshirojnë me mësuar në ndërrimin e parë që zhvillohet paradite dhe ka ankesa që me një klasë ka numër të madh të nxënësve dhe ulen nga dy nxënës me një bankë dhe nuk ka distancë në mes tyre.

**Sead Vila** thekson:- te shkolla fillor “Veli Ballazhi” nuk përputhet numri sipas paraleleve me numrin total të nxënësve por besoj që është gabim teknik.

**Sear Dernjani** thekson:- analiza për kovid ju është bërë 25 mësimdhënësve së bashku me drejtorin komunale të arsimit dhe drejtorin e shkollës së mesme “Dardania”. Sa i përket pyetjes që u parashtrua që po ulen nga dy nxënës me një bankë nuk qëndron sepse nëpër shkolla mbahet distanca dhe klasat janë ndarë nga dy grupe që ju ka përcaktuar edhe orari.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 10. Miratimi i kërkesës e z.Sulejman Doshllaku për ndërrim destinim të pronës.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Zaim Bela** thekson:- parashtruesi i kërkesë ka kërkuar që të bëhet ndërrim destinimi i kësaj prone sepse është duke ndërtuar shtëpi. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## U MIRATUA KËRKESA E SULEMNA DOSHLAKU PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS

### 3. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sead Vila** thekson:- është mbajtur punëtorja dhe është bërë ekipi punues për planin zhvillimorë të komunës 2020 – 2028 . Ku kanë mbërri punimet nga ekipi që është formuar për hartimin planit zhvillimorë komunal. Kërkoj përgjigje me shkrim.


**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:08.

**Procesmbajtësi**

**Azri Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**MSc. Qamush Brava**

